



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.165, datë 23.12.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, VKB NR.64, DATË 07.07.2020, VKB NR.81, DATË 10.08.2020, VKB NR.11, DATË 04.02.2021 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR NË ZBATIM TË EKSPERTIZAVE TË THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, VKM-së nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 55, datë 26.06.2020, VKB-së nr. 64, datë 07.07.2020, VKB-së nr. 81, datë 10.08.2020 dhe VKB-së nr. 11, datë 04.02.2021 përsa i përket listës emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar.
2. Heqjen nga lista e parë për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit në zbatim të ekspertizës së thelluar, e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur VKB nr.55, datë 26.06.2020, të subjekteve si mëposhtë vijon:

NR.	EMËR	MBIEMËR	DS	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	QEMAL	DISHANI	DS3	ISHËM

3. Heqjen nga lista e dytë për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit në zbatim të ekspertizës së thelluar, e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur VKB-së nr.64, datë 07.07.2020, të subjekteve si mëposhtë vijon:

NR.	EMËR	MBIEMËR	DS	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	QEMAL	JANGU	DS3	ISHËM
2	MUSTAFA	SELI	DS3	ISHËM
3	HAXHI	MUZHAQI	DS3	ISHËM

4. Heqjen nga lista e katërt për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit në zbatim të ekspertizës së thelluar, e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur VKB-së nr.81, datë 10.08.2020, të subjekteve si mëposhtë vijon:

NR.	EMËR	MBIEMËR	DS	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	SHPETIM	LUKU	DS2	MANËZ
2	MEHDI	LIKMETA	DS2	ISHËM

5. Heqjen nga lista e nëntë për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit në zbatim të ekspertizës së thelluar, e subjekteve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuar si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, që i është bashkëlidhur VKB-së nr.11, datë 04.02.2021, të subjekteve si mëposhtë vijon:

NR.	EMËR	MBIEMËR	DS	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	LULZIM	BERISHA	DS3	Nr. 5

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pikë 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 24.12.2021



07/01/22 83

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 998/prot.
/9

Durrës, më 05.01.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.165 datë 23.12.2021 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr 55 dt 26.06.2020, VKB Nr 64 dt 07.07.2020, VKB Nr 81 dt 10.08.2020, VKB Nr 11 dt 04.02.2021 përsa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve përfituese të grantit për rikonstruksionin ose riparimin e banesave të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 për shkak të ndryshimit të kategorisë së dëmit të shkaktuar në zbatim të ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

